

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkrire Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/a-shuhet-denimi-i-ish-luftetareve-te-uk-se-duke-shkrire-gjyka-ten-speciale-i104443
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:29:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:24:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ea0dd288d044ddd285607c9d939d0dcefad1321bc4978c03d2ccd205a325671e
TEKSTI	8715a124b75d38fb3c8db327224c87380574bb52667a2bdfd468681e86c6326f
PAMJA	76127590b311bd26ecfc7779b05c6f49482924e0a616e559565a7616300f4084

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	540bc20582d0015a223167c237035e6febfc2de3ff7721fc89adc0dfa33b449
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/540bc20582d0015a223167c237035e6febfc2de3ff7721fc89adc0dfa33b449

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

Gjykatën Speciale

të UÇK-së ka rikthyer në Kosovë

diskuton kartën e

tjera u diskutua një

UÇK-së, Serbia

tha se aktgjy...

shqiptare reagon pas

vendim drastik ndaj ish krerëve

për protesta

Kristaq Ziu ka reaguar në

KOSOVA

A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkrirë Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 14:24



Vendimi i sotëm i Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së ka rikthyer në Kosovë debatin nëse Kuvendi mund të ndërhyjë për të shfuqizuar Gjykatën Speciale.

Hashim Thaçi u dënua në shkallë të parë me 25 vjet burg, Jakup Krasniqi me 25 vjet, Kadri Veseli me 18 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet. Të katër u shpallën fajtorë për katër akuzat për krime lufte, ndërsa u shpallën të pafajshëm për gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit. Vendimet nuk janë përfundimtare dhe mund të apelojnë.

Por a mund ta "shkrijë" Kuvendi i Kosovës Gjykatën dhe, nëse po, a do të liroheshin automatikisht të dënuarit? Nga shqyrtimi i Kushtetutës së Kosovës, Ligjit 05/L-053 dhe marrëveshjes Kosovë-Holandë, përgjigjja është më e ndërlikuar.

Dhomat e Specializuara janë pjesë e sistemit juridik të Kosovës dhe baza e tyre është futur drejtpërdrejt në Kushtetutë përmes Amendamentit nr. 24 dhe nenit 162. Kushtetuta u jep atyre kompetencë për gjykim, paraburgim dhe madje për vuajtjen e dënimeve jashtë Kosovës, si dhe për administrimin e çështjeve të mbetura edhe pas përfundimit të mandatit.

Pikërisht për këtë arsye, vetëm shfuqizimi i Ligjit 05/L-053 nga Kuvendi nuk do të mjaftonte për ta zhdukur bazën kushtetuese të Gjykatës. Neni 162 do të vazhdonte të ishte pjesë e Kushtetutës.

Nëse synimi do të ishte ndryshimi ose heqja e nenit 162, do të duhej të ndiqej procedura e amendamentimit të Kushtetutës.

Sipas nenit 144, propozimin mund ta bëjnë Qeveria, Presidenti ose të paktën një e katërta e deputetëve. Për miratim duhen dy të tretat e të gjithë 120 deputetëve, pra të paktën 80 vota, dhe njëkohësisht dy të tretat e deputetëve që mbajnë 20 vendet e garantuara për komunitetet joshumicë — praktikisht të paktën 14 prej tyre. Përpara votimit, amendamenti duhet t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese për kontroll paraprak nëse cenon të drejtat dhe liritë e Kapitullit II.

Ligji për Dhomat e Specializuara parashikon shprehimisht se institucionet, dosjet, arkivat dhe funksionet e Gjykatës mbrohen nga ndërhyrjet, përfshirë ato me veprim legjislativ. Po ashtu parashikohet një mekanizëm rezidual, i cili mund të vazhdojë të administrojë çështjet pasi të gjitha vendimet të bëhen përfundimtare.

Pra, nuk ekziston në ligj një dispozitë sipas së cilës mbyllja e institucionit anulon automatikisht vendimet penale që ai ka dhënë.

Në situatën aktuale, rruga e drejtpërdrejtë që parashikon ligji është **Apeli**. Paneli i Apelit mund ta lërë në fuqi vendimin, ta ndryshojë ose ta rrëzojë atë. Ligji parashikon që, si rregull, i dënuari

qendron ne paraburgim gjate shqyrtimit te apeit, pervecse kur paneli vendos ndryshe.

Pas një vendimi përfundimtar ekzistojnë edhe mjete të jashtëzakonshme juridike, përfshirë rihapjen e procedurës në rrethana të caktuara dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Por ligji përjashton një mundësi tjetër që ekziston për të dënuarit nga gjykatat e zakonshme të Kosovës: Presidenti i Kosovës nuk mund t'i falë personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara. Kohëzgjatja e dënimit mund të ndryshohet vetëm nga vetë Dhomat e Specializuara ose nga mekanizmi i tyre rezidual.

Në vitin 2017 pati një përpjekje politike të ngjashme, kur 43 deputetë të Kuvendit nisën iniciativën për shfuqizimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara. Bashkimi Evropian e kundërshtoi publikisht atë nismë, duke argumentuar se Kosova kishte marrë detyrime ndërkombëtare për funksionimin e Gjykatës.

Kuvendi mund të tentojë ndryshimin e ligjit dhe Kushtetutës, por një proces i tillë do të kërkonte shumicë kushtetuese, kontroll paraprak kushtetues dhe do të përballej me dispozitat që e lidhin përfundimin e mandatit me njoftimin e Këshillit të BE-së. Edhe mbyllja e Gjykatës, sipas mekanizmit të parashikuar sot, nuk i anulon vetvetiu vendimet e saj dhe as nuk krijon një detyrim për Holandën që t'i lirojë të dënuarit.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator14:05

[Haga dënoi me 81 vite burg në total 4 ish-krerët e UÇK-së, Serbia thyen heshtjen](#)

Zëvendëskryeministri dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Dačić, tha se aktgjy...

KOSOVA 16 Shtator14:02

[Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit](#)

Gjykata Speciale e Hagës dënoi sot me 81 vite burg të katër ish liderët e UÇK-së, Hashim Thaçin (25 vite burg), Ka...

KOSOVA 16 Shtator14:00

[“UÇK nuk është vetëm një emër në histori”/ Sulmuesi i Kombëtares shqiptare reagon pas vendimit të marrë në Hagë](#)

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, morën këtë të enjtë një vendim drastik ndaj ish krerëve t&eu...

KOSOVA 16 Shtator13:57

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-Vendimi i Hagës/ Thirrje për protesta më të fuqishme, grisët flamuri i BE](#)

Kryetari i Shoqatës Atdhetare për Bashkim dhe Identitet Kombëtar, Kristaq Ziu ka reaguar në një deklaratë për mediat, n&eum...

KOSOVA 16 Shtator13:48

[Albulena Haxhiu: Dënimet janë goditje e rëndë, fjala e fundit juridike nuk është thënë](#)

Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, i ka cilësuar dënimet ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit,...

KOSOVA 16 Shtator13:41

[Dënimi me 81 vite burg për krerët e UÇK-së, Ali Ahmeti: Kosova luftoi për liri, shpresë tek vendimi i Apelit](#)

Ish-kryeministri e ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së janë dënuar me nj...

KOSOVA 16 Shtator13:40

[Gjykata Speciale dënoi Thaçin më shumë se Serbia, Haga i dha 25 vite, Millosheviçi e kishte dënuar me 10 vite në qeli](#)

Gati tri dekada para dënimit me 25 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë, Hashim Thaçi ishte dënuar në mungesë e...

KOSOVA 16 Shtator13:29

[“Serbia vrau mbi 13 mijë persona”, Osmani: UÇK ishte betimi i përgjakur i njerëzve të shtypur që donin çlirimin](#)

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë,...

KOSOVA 16 Shtator13:26

[“Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli”, reagon vajza e Jakup Krasniqit: Unë do të vdes me bindjen në pafajësinë e babait tim](#)

Pas vendimit të sotëm në Hagë, ka reaguar edhe vajza e Jakup Krasniqit, Gresë Krasniqi. Në një status të publikuar n&...

KOSOVA 16 Shtator13:24

[“Serbia mori goditje”, Ben Andoni: Beogradi nuk e pranon realitetin, do ketë Banjska të tjera](#)

Analisti Ben Andoni, i ftuar në News24 komentoi dënimin me 81 vite burg për komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosov&eu...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

[Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...](#)

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një&eum...

POLITIKE 15 Shtator

[“S’ju pje*dh njeri”, Korreshi përplaset me Gogu...](#)

Ndërsa Korreshi fliste për gjyqtarët me tone të ashpra, ministri Gogu iu drejtua duke i thënë se deputeti i PD ende nuk e ka kup...

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.